



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit 22.12.1 -2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË**  
**DRAGASHIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunes së Dragashit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi , i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Kapllan Muhaxheri Udhëheqës ekipi, Alban Beka dhe Arian Zenelaj Anëtarë, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli.....	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	26
5 Qeverisja e mirë.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	31
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	34
Shtojca III: Letër konfirmimi .....	43

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Komunës së Dragashit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 07/11/2017. Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Dragashit.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës së Dragashit për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, përveç:


- Pagesave të parregullta nga investimet kapitale për furnizime dhe punë të pa pranuar/përfunduara në vlerë 41,250€;
- Mbivlerësimi të të hyrave për 49,411€ si pasojë e prezantimit të të hyrave indirekte (gjobave të trafikut dhe gjykatave) të cilat mbledhen nga institucionet qendrore; dhe
- Pagesës së pagave jubilarë në vlerë 10,951€ nga kategoria e investimeve kapitale.

#### **Theksimi i çështjes**

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se informatat e shpalosura për pasuri në pasqyrat financiare nuk ishin të plota dhe të sakta.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

---

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

ZKA është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Dragashit. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme, e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditim.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Dragashit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

#### Baza për opinion

Ne kemi kualifikuar opinionin e auditimit për faktin se:

- Tek projekti "Asfaltimi i rrugës në fshatin Restelicë - Strezimir - kalimi kufitar (L=5000m)", komuna ka paguar faturën për Situacionin nr. II në vlerë 100,000€, bazuar në raportin e pranimit të punimeve i datës 27/10/2017 i vërtetuar nga menaxheri i kontratës. Brenda këtij situacioni ishte i përfshirë edhe pozicioni me Nr. 4.2 - Punimi i rigollave të betonit të gatshëm së bashku me anësorët në gjatësi prej 5,000m. Gjatë ekzaminimit fizik me prezencën edhe të zyrtarëve komunal, konstatuam se punimet për këtë pozicion nuk ishin realizuar. Vlera totale e këtij pozicioni ishte 41,250€ apo 41% e situacionit;

- Te neni 14 “Raporti i ekzekutimit të buxhetit” ishin prezantuar gabimisht edhe të hyrat indirekte (të hyrat nga gjobat e trafikut dhe gjykatave si dhe të hyrat nga gjobat e agjencisë së pyjeve), duke mbivlerësuar të hyrat e pranuar prej 49,411€; dhe
- Në pesë pagesa në vlerë 10,951€, sipas zyrtareve komunal janë bërë për kompensimin e mësimdhënësve me rastin e pensionimit, pagave jubilarë.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Komuna e Dragashit dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

### Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ nuk janë përfshirë parcela të tokave të regjistruar në kadastër në sipërfaqe prej 30,036 hektarë;
- Në regjistrin kontabël të pasurisë janë evidentuar tri projekte kapitale – investime në vijim në vlerë 222,264€<sup>1</sup>. Si pasojë pasuritë janë nënvlerësuar për pjesën e zhvlerësimit të tyre; dhe
- Për shkak të mangësive në regjistrin e pasurisë kapitale nuk mund të përcaktohet realisht vlera e zhvlerësimit të llogaritur nga sistemi, përkatësisht përcaktimi i saktë i vlerës neto në libra për pasuritë e prezantuara në PFV te Neni 19.3.1.

Opinionin jonë nuk është kualifikuar për këtë çështje.

### Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Dragashit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

<sup>1</sup> 621171088 “Asfaltimi i rrugës në fshatin Restelicë” - 100,000€; 621171087 “Asfaltimi i rrugës Zaplluxhe - qendra turistike” - 110,000€; dhe 621171404 “Ndërtimi i objekteve të infrastrukturës në fshatin Kosave” -12,265€.



Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Plani fillestar dhe final i prokurimit;
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të AB-së dhe ZKA-së nga KK; dhe
- Raportet e rregullta tremujore për thesarin, përfshirë Pasqyrat Nëntëmujore

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç çështjeve të prezantuara në opinionin e auditimit.

Në këtë kontest të raportimit të jashtëm kemi vërejtur se komuna ka plotësuar kënaqshëm të gjitha kërkesat për raportim, përveç raportimit mujor të obligimeve në MF, sipas Rregullës financiare 02/2013.

---

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipërpërmendura jepen rekomandimet, si në vijim:

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i forcuar kontrollet në procesin e pagesave, në mënyrë që të evitohen pagesat për të cilat punët/furnizimet nuk janë kryer. Komuna duhet të emërojë një komision të veçantë për punët/furnizimet, e pa pranuar/përfunduara i cili do të monitoroj ketë proces deri në kompletimin e plotë të tyre, në të kundërtën mjetet financiare të kthehen në buxhetin komunal. Veprime specifike duhet të merren gjithashtu për të eliminuar mundësinë për prezantimin e gabimeve lidhur me të hyrat dhe shpenzimet, si dhe për të siguruar se regjistrat e pasurisë janë të plotë dhe të saktë.

Gjithashtu, kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna ka të dizajnuar një sistem të mirë të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat. Megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me të hyrat, prokurimin, si dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive në përgjithësi janë të dobëta dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime, janë procesi i menaxhimit dhe raportimit të llogarive të arkëtueshme dhe obligimeve.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>7,550,914</b>	<b>8,195,579</b>	<b>6,731,818</b>	<b>6,299,426</b>	<b>6,974,454</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	6,799,239	6,805,948	6,341,807	6,047,798	6,476,119
Huamarrja	-	24,326	14,425	-	-
Të hyrat bartura <sup>3</sup>	-	530,301	82,193	84,140	195,418
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	751,675	751,675	223,093	121,434	194,465
Donacionet e brendshme	-	-	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	83,329	70,300	46,054	108,452

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 644,665€. Kjo ishte rezultat i të hyrave vetjake të bartura nga viti 2016 në vlerë 530,301€; rritjes së donacioneve në vlerë 83,329€; rritjes nga granti qeveritar në vlerë 6,709€, në bazë të vendimit të qeverisë; si dhe rritjes prej 24,326€ nga fondi për huamarrje nga një marrëveshje me Ministrin e Shëndetësisë për regjistrimin e pacienteve të kontrolluar dhe evidentuar në sistemin integruar informativ shëndetësor.

Në vitin 2017, komuna e ka shpenzuar 82% të buxhetit final apo 6,731,818€, me një performancë më të ulët prej rreth 10% krahasuar me vitin 2016 (92%) megjithëse sipas kategorive ekonomike niveli më i ulët i realizimit ishte te investimet kapitale në vetëm 59%. Realizimi i buxhetit në tërësi mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>7,550,914</b>	<b>8,195,579</b>	<b>6,731,818</b>	<b>6,299,426</b>	<b>6,974,454</b>
Pagat dhe Mëditjet	4,233,292	4,253,510	4,252,501	4,243,671	4,149,043
Mallrat dhe Shërbimet	605,220	773,015	569,989	571,476	564,700
Shërbimet komunale	130,000	130,000	108,277	115,126	108,252
Subvencionet dhe Transferet	24,663	34,663	34,445	23,545	30,000
Investimet Kapitale	2,557,739	3,004,391	1,766,606	1,345,608	2,122,459

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Tek kategoria e pagave dhe mëditje, buxheti final ishte rritur për 20,216€, dhe ishte shpenzuar në nivel 99% e buxhetit final;
- Pavarësisht rritjes së buxhetit për investime kapitale në vlerë 446,651€, realizimi për këtë kategori është shpenzuar vetëm 59% e buxhetit final. Për më tepër, ka dallime të mëdha në mes të planifikimit të prokurimit për investime kapitale dhe realizimin e këtyre investimeve. Kjo është sfida kryesore që duhet të adresohet nga menaxhmenti;
- Buxheti për mallra dhe shërbime kishte rritje mbi 27% krahasuar me buxhetin fillestar dhe ishte shpenzuar në nivel prej 74%. Dinamika e realizimit nuk është në harmoni me planifikimet, sepse 54% e shpenzimeve janë realizuar në tremujorin e fundit të vitit;
- Buxheti final për shërbimet komunale nuk kishte ndryshime krahasuar me buxhetin fillestar, dhe ishte shpenzuar në nivel 83% ndërsa në fund të vitit 2017 nuk kishte asnjë obligim të prezantuar; dhe
- Buxheti për subvencione dhe transfere kishte rritje prej 10,000€ krahasuar me buxhetin fillestar dhe ishte shpenzuar në nivel prej 99% e buxhetit final.

## Çështja 2 - Nivel i ulët i realizimit të investimet kapitale

**E gjetura** Ekzekutimi i ulët lidhur me investimet kapitel është sfida kryesore me të cilën përballet komuna. Vetëm 59% e buxhetit të kësaj kategorie është shpenzuar dhe çështja nuk është adresuar nga menaxhmenti përkundër faktit se është trajtuar në raportin e mëparshëm të auditimit (në vitin 2016 ishte 78%).

Kjo kishte ndodhur nga që menaxhmenti nuk kishte bërë një planifikim real të shpenzimeve si dhe nuk kishte bërë analiza në baza të rregullta, mbi ecuritë buxhetore. Kjo ka shkaktuar që fondet vetjake në vlerë 637,935€ janë bartur si të pa shpenzuara në vitin vijues.

**Rreziku** Shfrytëzimi jo efektiv i fondeve në dispozicion, do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës, me pak projekte për qytetaret dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë që përforma buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

## 3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin 363,709€. Si kategori dominuese në strukturën e hyrave vetjake është nga inkasimi i të hyrave të tatimit në pronë, taksat administrative, taksa për regjistrimin e automjeteve, etj. Komuna ende nuk ka të vendosur kontrole të brendshme efektive që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë agregimin e tyre në PFV. Në totalin e të hyrave vetjake të realizuara në tabelën në vijim nuk janë prezantuar të hyrat nga gjobat e trafikut (28,107€), gjobat nga gjykata (9,305€), si dhe të hyrat nga ekonomia e pyjeve (11,999€).

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	751,675	751,675	363,709	418,123	349,061

Të hyrat vetjake janë shpenzuar kryesisht për projekte kapitale 50%, mallra dhe shërbime 39%, pjesa tjetër prej 11% është shpenzuar në kategorinë e subvencioneve.

Gjatë vitit 2017 janë inkasuar të hyra nga tatimi në pronë për këtë vit dhe vitet e mëhershme 194,140€, (shuma prej 78,358€ ishin arkëtime nga faturimi i vitit 2017), kurse faturimi vetëm për këtë vit është 217,626€. Komuna nuk ka aplikuar ndonjë qasje pro aktive për mbledhjen e tatimit në pronë.

---

### Çështja 3 – Regjistrimi dhe prezantim jo i drejt i të hyrave

- E gjetura** Rregullorja financiare për të hyrat 03/2010 përcakton se organizatat buxhetore bëjnë regjistrimin e të hyrave në SIMFK në bazë të faturave të lëshuara dhe raporteve të bankës. Ne dy<sup>5</sup> raste kemi konstatuar se të hyrat nga lejet e ndërtimit janë regjistruar në kodin ekonomik 50218 “licenca ndërtimore” ndërsa është dashur të regjistrohen në kodin ekonomik 50009 “taksa komunale për leje ndërtimi”.
- Rreziku** Regjistrimi dhe prezantimi i gabuar i të hyrave rezulton që informatat për zëra të veçantë brenda kategorisë së të hyrave të mos jenë të sakta.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të siguroj se ndërmerren aktivitete të domosdoshme që të hyrat regjistrohen dhe prezantohen në përputhje të plotë me planin kontabël.

### Çështja 4 - Menaxhim jo adekuat i të hyrave nga tatimi në pronë

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin (ri anketimin) e 1/3 së pronave të paluajtshme siç kërkohet me Ligjin për Tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi me qëllim të përditësimit të shënimeve ekzistuese. Nga gjithsej 9,970 prona, komuna gjatë këtij viti ka arritur të verifikoj vetëm 1,323 prona ose 13%.
- Sipas nenit 9 të Ligjit mbi tatimin në pronë, çdo person fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos se prona ose njësia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës. Ne kemi identifikuar tri raste ku komuna nuk kishte vepruar në përputhje me ligjin për arsye se kishte tatimpagues që posedonin dy apo më tepër prona të regjistruara si banim kryesor dhe për secilën pronë është aplikuar zbritja prej 10,000€, nga vlera e tatueshme e pronës.
- Rreziku** Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të mos jenë të sakta. Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë rezulton me të hyra më të ulëta për këtë kategori.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se verifikimi i pronave të bëhet në baza të rregullta vjetore sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, që reflekton shënime të përditësuara të regjistrimit dhe ngarkesave të sakta tatimore. Veprime shtesë duhet të ndërmerren që të siguroj se zbritjet për 10,000€ aplikohet vetëm për vendbanimet kryesore.

---

<sup>5</sup> Taksa komunale për lejen e ndërtimit në vlerë 5,284€ dhe taksë komunale për leje ndërtimi në vlerë 1,148€.

## Çështja 5 - Parregullsi në dhënien me qira të pronave komunale

- E gjetura** Në tri (3)<sup>6</sup> raste komuna ka shpërblyer me kontrata për shfrytëzimin e pronës publike, pa ankand publik. Sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës publike, afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës jepet nga një deri në 15 vite dhe duhet të bëhet përmes ankandit publik. Kemi identifikuar se 87 prona komunale shfrytëzohen pa kontrata. Në një rast, qiramarrësit i kishte përfunduar kontrata në fund të vitit 2012. Nga zyrtaret e komunës kemi marr konfirmim se i njëjti vazhdon ta shfrytëzoj pronën pa u ngarkuar që nga përfundimi i kontratës, dhe në këtë rast borxhi ndaj komunës deri në vitin 2012 është 10,540€.
- Rreziku** Dhënia në shfrytëzim e pronave publike pa ankand publik, eliminon mundësinë e pjesëmarrjes së personave tjerë të interesuar dhe dëmton parimin e transparencës dhe konkurrencës. Dobësitë e identifikuara në menaxhimin e kontratave të qiradhënieve rezultojnë me humbje financiare për komunën.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet t'i analizoj rastet e përmendura më lartë dhe të siguroj së dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim të jetë në harmoni të plotë me kërkesat ligjore. Gjithashtu, në të ardhmen, të siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës publike të organizohet sipas procedurës së ankandit publik dhe të nënshkruhen kontratat sipas legjislacionit.

### 3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 4,253,510€ ndërsa shpenzimet ishin prej 4,252,501€ apo mbi 99%.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

<sup>6</sup> H.H.; H.T.; Ipko Telecommunications.



---

## 3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i stafit të miratuar ishte 776 punonjës, ndërsa numri aktual i punonjësve është 675. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit si dhe dosjet e personelit për të verifikuar rregullsinë e tyre.

---

### Çështja 6 - Mungesë e dëshmime për punët jashtë orarit dhe përvojës së punës

**E gjetura** Bazuar në Ligjin e Punës pagesa për punë jashtë orarit llogaritet për çdo orë pune, duke i shtuar edhe vlerën shtesë të llogaritur mbi pagën bazë (20%, 30% dhe 50%). Në dy raste nuk na janë ofruar dëshmi relevante/evidenca të nxjerra nga Libri i Kujdestarive për llogaritjen e kompensimit në vlerë 75€ si dhe në rastin tjetër 36€, për punë jashtë orarit (kujdestarit) në QKMF. Edhe pse efekti financiar i mospërputhjeve të evidentuara nuk konsiderohet se është i lartë, vet fakti i ekzistimit të mangësive të tilla është tregues i mungesës së efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Gjatë auditimit të dosjeve të mësimdhënësve në sektorin e arsimit, dëshmitë për vitet e përvojës së punës nuk ishin të pasqyruara me një vendim të vërtetuar nga zyrtaret e autorizuar të personelit dhe i punësuari.

**Rreziku** Mungesa e evidencave nuk justifikon pagesat për kujdestari, dhe kalkulimi mund të rezultojë edhe me gabime në saktësinë e pagesave. Mangësitë e tilla rezultojnë me pagesa të parregullta dhe menaxhim jo adekuat të shpenzimit të pagave. Deri sa nuk kemi një pasqyrë të dëshmime të besueshëm dhe të mjaftueshme të përvojës së punës, të kontrolluar dhe autorizuar nga stafi kompetent, ka rrezik se të behën mbi pagesa apo nën pagesa në emër të përvojës së punës.

**Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurojë që kompensimi i punëtorëve për punë jashtë orarit/kujdestarive të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, të mbaj evidenca të rregullta, në mënyrë që pagesa e tyre të jetë e rregullta dhe e dokumentuar. Si dhe duhet të siguroj që zyrtarët e personelit të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës së të punësuarave duke respektuar Vendimin e Qeverisë nr.06/29 të dt.15/05/2015 që përcakton rregullat dhe procedurat për dëshmimin e përvojës së punës.

## Çështja 7 - Mungesë e dosjeve të personelit

- E gjetura** Për tre zyrtarë të cilët janë të angazhuar në Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe paguhen nga komuna, zyrtarët përgjegjës nuk ishin në gjendje të na ofrojnë dosjet e kompletuara dhe kontratat e këtyre zyrtarëve, në bazë të të cilave kryhet kompensimi i pagave. Sipas menaxherit të personelit kjo dukuri është shfaqur si pasojë e një Memorandumi të mirëkuptimit, ku është formuar një komision i përbashkët për pranim e stafit, mjeteve buxhetore, si dhe pranim/dorëzimin e inventarit nga drejtoria komunale në Dragash në drejtorin për administrimin e parkut kombëtar “Sharr” në Prizren. Në pikën II të këtij proces verbali theksohet se mjetet buxhetore sipas kategorive të shpenzimeve, pagat do të transferohen nga niveli komunal në AMMK, por një dukuri e tillë edhe me tej nuk ka ndodhur, dhe kjo pasqyron një mungesë të specifikave të qarta për burimet njerëzore që ndërlidhen me zbatimin e kërkesave të UA-ve si pjesë e përshkrimit të detyrave të tyre të punës.
- Rreziku** Pagesat për zyrtarët në mungesë të dokumentacionit relevant, rezultojnë në pamundësinë për të justifikuar pagën/shtesat ose për të mundësuar shqyrtimin e rezultateve nga vlerësimet e performancës.
- Rekomandimi 7** Kryetari të siguroj rishikimin e marrëveshjes së mirëkuptimit dhe të gjej mundësi që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre.

## 3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti aktual për mallra dhe shërbime 903,015€ (mallra 773,015€ dhe shpenzime komunale 130,000€) ndërsa shpenzimet 678,266€ (mallra dhe shërbime 569,989€ dhe shpenzime komunale 108,277€) ose shprehur në përqindje 75% e buxhetit.

## Çështja 8 - Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta

- E gjetura** Komuna gjatë vitit 2017 kishte angazhuar nëntë punonjës me kontrata për shërbime të veçanta. Pagesa për këto shërbime ishte bërë nga kategoria mallra dhe shërbime. Katër nga kontratat ishin lidhur për pozita të zakonshme e jo për ekspertë të fushave përkatëse. Asnjërit prej të angazhuarve nuk iu kishte ndalur tatimi në burim, siç përcaktohet me ligjin Nr. 05-L-028.

**Rreziku** Angazhimi i stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta për mbulimin e pozita të zakonshme ndikon në rritjen e shpenzimeve të shërbimeve kontraktuese dhe mund të rezultojë me shërbimet jo reale krahas nevojave të komunës. Mos ndalesa e tatimit në burim për personat e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, rrit rrezikun që komuna të jetë objekt i ndëshkimeve nga autoritetet tatimore.

**Rekomandimi 8** Kryetari duhet të siguroj që kontratat e tilla të përdorën vetëm për shërbime të veçanta dhe jo për pozita të zakonshme. Ndërsa mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, duhet të bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

### 3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere është 34,663€ prej tyre në 2017 janë shpenzuar 34,445€ ose 99%, ato kanë të bëjnë me subvencionimin për entitete publike, klube të sportit, organizatave jo qeveritare të ndryshme, shoqëri kulturo artistike etj. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 10,900€, kjo është reflektuar nga rritja e buxhetit në krahasim me vitin e kaluar.

#### Çështja 9 – Regjistrim dhe prezantim i gabuar i subvencioneve

**E gjetura** Dy pagesa për subvencionim në vlerë 1,000€ dhe 950€ ishin regjistruar gabimisht në kodin ekonomik “21110 - Subvencionim për entitet publike”, ndërsa për nga natyra pagesa i takonin subvencioneve për entitete jo publike që duhej të regjistrohet në kodin ekonomik “21200”.

**Rreziku** Regjistrimi i shpenzimeve në kode joadekuate rezulton me pasqyrim jo të drejtë të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të siguroj që zyrtari i shpenzimeve e bën klasifikimin e duhur të shpenzimeve sipas planit kontabël dhe pagesat për subvencione të regjistrohen nëpër kodet përkatëse.

## 3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,004,391€. Prej tyre në 2017 janë shpenzuar 1,766,606€, apo në shkallen prej 59%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, objekteve shkollore, etj.

### Çështja 10 – Dobësi në menaxhimin e kontratave dhe pagesave për investime kapitale

**E gjetura** Disa nga projektet nuk kanë mundur të finalizohen për shkak të mos eliminimit të pengesave tjera paraprakisht, si në vijim:

- Menaxheret e caktuar për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punimeve në pesë<sup>7</sup> raste kanë lëshuar raportin përfundimtar të pranimit të punëve për projektet të cilat ende nuk janë realizuar sipas vlerës së kontratës dhe paramasave. Sipas menaxhereve të kontratës kjo dukuri është zbatuar në shumicën e rasteve pasi operatorët nuk kanë arritur t'i përfundojnë projektet deri në fund të viti fiskal dhe mjetet janë bartur në suficit. Vlera totale e këtyre kontratave ishte 121,007€, prej tyre janë realizuar punime në vlerën prej 95,748€ ndërsa punët e pa përfunduara për të cilat janë përmbyllur kontratat arrijnë vlerën prej 25,259€;
- Në katërs raste komuna nuk kishte bërë hartimin e projektit ekzekutiv. Sipas udhëzimit administrativ Nr. 1/2014 Për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë kërkohet që Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetëm, një projekt ekzekutiv të përpiluar; dhe
- Gjashtë pagesa nga investimet kapitale në vlerë 13,544€ janë paguar direkt nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësore dhe përmbaruesit privat, ku vetëm për shpenzimet administrative dhe shpenzime tjera përmbarimore janë paguar 2,304€.

**Rreziku** Mangësitë e identifikuara kanë rezultuar me mos respektim të procedurave të prokurimit sipas Udhëzimit Operativ të LPP-së. Komuna nuk ka arrit të përmbush objektivat e planifikuara e infrastrukturës në shërbim të taksapaguesve apo kthimin e kundërvlerës për taksën e paguar të qytetarit të Dragashit. Me tutje zhvillimi i procedurave të prokurimit pa një projekt të hartuar paraprakisht mund të ndikoj që punimet e zbatuara në këto projekte të devijojnë nga kërkesat standarde të ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.

<sup>7</sup> “Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Radesh” - 32,988€; “Ndërtimi i rrugës Kuklibek- Bjeshkë” - 14,920€; “Ndërtimi i shkollëve në drejtim të shkollës së mesme” - 20,918€; “Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Zaplluxhe” - 27,657€; dhe “Ndërtimi i objekteve të infrastrukturës në fshatin Kosavë” - 24,525€.

<sup>8</sup> “Asfaltimi i rrugës në fshatin Rapçë (shtresa e dytë) d=5cm” - 63.547€; “Kubëzimi i rrugëve në fshatin Rapçë” - 13.115€; “Furnizimi dhe montimi i pompave të ujësjellësit në fshatin Rrenc” - 5.890€; “Meremetimi i rezervuarit dhe pusetave të rrjetit të ujit në fshatin Shajne” - 14,922€.

**Rekomandimi 10** Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha zotimet e kontraktuara janë duke u realizuar në përpikëri dhe konform kushteve të parashtruara, duke eliminuar pengesën para hyrjes në marrëveshje kontraktuese. Nëse përjashtimisht paraqitet nevoja për ndërprerje të kontratës duhet të ndiqen procedurat e nevojshme sikurse është paraparë me Ligjet dhe Udhëzimet në fuqi. Gjithashtu duhet të siguroj se hartimi i projekteve ekzekutive i paraprinë inicimit të aktiviteteve të prokurimit të kontratat për punë sipas kërkesave të UA nr. 1/2014.

### 3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Për vitin fiskal 2017 sipas planifikimit të prokurimit janë planifikuar 72 procedura të prokurimit, mirëpo janë realizuar 80, duke tejkaluar planifikimin për mbi 10%. Për tetë procedura të cilat nuk qenë të përfshira në planin e prokurimit është njoftuar paraprakisht AQP sipas Ligjit të prokurimit në fuqi.

#### Çështja 11 - Shmangie e procedurave të hapura të prokurimit

**E gjetura** Sipas raportit të kontratave të nënshkruara për vitin 2017 komuna kishte nënshkruar 42 kontrata përmes procedurës me vlerë minimale. Gjatë auditimit të 12 kontrata kemi vërejtur se ka ndarje të tenderëve, ku për furnizime dhe shërbime të natyrës së njëjtë janë zhvilluar një numër i procedurave si:

- “Furnizim me goma” janë zhvilluar dy procedura në vlerë totale 1,574€;
- “Furnizim me kompjuter” janë zhvilluar tri procedura në vlerë totale 2,118€; dhe
- “Mirëmbajtje dhe riparime” janë zhvilluar katër procedura në vlerë totale 3,955€.

**Rreziku** Praktika e tillë shton rrezikun e mos arritjes së vlerës për para dhe dëmtojnë transparencën, eliminojnë konkurrencën dhe vejnë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve dhe produkteve të pranuar.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.

## Çështja 12 - Mangësi në pranimin, regjistrimin dhe prezantimin e shpenzimeve

**E gjetura** Ne kemi vërejtur se në të gjitha pagesat e testuar përmes procesit të prokurimit zyrtari pranues nuk përshkruan fare se çfarë, dhe sa është furnizuar, mirëpo vetëm e nënshkruan raportin e pranimit pa asnjë koment. Gjithashtu, kemi identifikuar se komuna në dy raste kishte bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve në kategori ekonomike:

- Pagesa në vlerë 1,196€ “shërbime kontraktuese tjera” ishte paguar nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, ndërsa është dashur të paguhet nga kategoria e pagave dhe mëditje; dhe
- Të pagesa në vlerë 2,022€ ishte paguar nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, ndërsa është dashur të paguhet nga investimet kapitale, pasi që kishte të bënte me shpronësimin e tokës.

**Rreziku** Mungesa e informacioneve për pranimin e mallrave apo shërbimeve para se pagesa të procesohet paraqet rrezik që komuna të bën pagesa për mallrat të cilat nuk janë pranuar në cilësi dhe sasi sipas kontratës. Përdorimi i fondeve në kundërshtim me ligjin për ndarjet buxhetore, rezulton me mbivlerësimin e njëjës kategori dhe nënvlerësimin e tjetrës si dhe mos shpalosjet e duhura ndikojnë negativisht për shfrytëzuesit e informatave të PFV.

**Rekomandimi 12** Kryetari duhet të sigurojë se zyrtari i pranimi bën përshkrimin e mallit/punës të pranuar me qëllim të konfirmimit se furnizimet/punët janë pranuar konform kontratës, nga ana e zyrtareve kompetent. Gjithashtu duhet të vendos kontrolle funksionale për tu siguruar se pagesat bëhen sipas kodeve adekuate dhe të krijohet një strategji e përgjithshme për të përfshirë buxhetimin e tyre me kohë.

## 3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Vlera e tërësishme e pasurisë mbi 1,000€ ishte 18,954,000€, ndërsa ato nën 1,000€ ishin prezantuar në vlerën prej 299,000€. Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 2.1 Opinioni për Pasqyrat Vjetore Financiare.

---

**Çështja 13 - Mangësi në inventarizimin e pasurisë**

**E gjetura** Raporti i komisionit për inventarizimin e pasurisë ishte i mangët, përmban vetëm pasurinë e administratës së komunës, por jo edhe pasuritë jo financiare të shkollave, objekteve shëndetësore dhe qendrave për punë sociale. Neni 19.4 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare thekson se përgjegjësitë e komisionit për inventarizim ndër të tjera janë “Inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore”.

Përkundër që komisioni i inventarizimit kishte identifikuar pasuri të dëmtuar si dhe pasuri me vlerë zero, nuk kemi vërejtur së është formuar një komision për vlerësimin e pasurisë, për të vlerësuar nëse ato duhet të largohen nga përdorimi ose të tjetërsohen, ashtu siç kërkohet me Rregulloren MF. nr. 02/2013. Për me shumë me rastin e ekzaminimit fizik në QKMF dhe në Administratë kemi konstatuar se disa automjete ishin në gjendje pasive me vite apo jashtë përdorimit. Komuna mbante në regjistrin kontabël një automjet me vlerë zero, ndërsa gjatë ekzaminimit kemi konstatuar se janë tri automjete të tipit të njëjtë. Komisioni i inventarizimit një lëshim të tillë nuk e ka evidentuar si parregullsi.

**Rreziku** Mos realizimi i plotë i inventarizimit të pasurisë siç kërkohet me rregullore, mund të rezultojë që komuna të mos identifikoj gjendjen reale dhe faktike të pasurive të cilat mund të jenë të dëmtuara ose mungojnë plotësisht. Kjo mund të rezultojë në mbajtjen në pasqyrat financiare të pasurive të cilat nuk ekzistojnë apo kanë vlerë më të ulët se ajo me të cilën ata janë prezantuar në PFV.

**Rekomandimi 13** Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëj regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.

**Çështja 14 - Mungesë e procedurës së brendshme dhe regjistrit të pasurisë nën 1,000€**

**E gjetura** Neni 4.1 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare thekson se “Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare”. Komuna nuk ka procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë përkundër që ishte rekomandim në raportin e vitit të kaluar.

Sistemi i E-pasurisë nuk funksionon dhe komuna nuk ofron regjistër të pasurisë nën 1,000€, siç është paraparë në nenin 6, të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive financiare.

**Rreziku** Mungesa e procedurave të brendshme për ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë mund të ndikoj që pasuria e komunës mos të menaxhohet si duhet dhe mos të prezantohet drejtë në pasqyrat financiare. Ndërsa, po ashtu, për vlerën e pasurive, nën 1,000€ të prezantuara në PFV nuk ishim në gjendje të verifikojmë saktësinë e tyre për shkak të mungesës së regjistrit.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013, si dhe të sigurojë se procesi gjithëpërfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj, dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës. Po ashtu të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit e-pasuria në të gjitha dikasteret komunale.

**3.10 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj**

Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësive më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

**Çështja 15 - Vonesa në depozitimin e parasë së gatshme**

**E gjetura** Rregullorja financiare për të hyrat 03/2010 përcakton që të hyrat e grumbulluar në formë të parasë së gatshme në arkë (në shumën 10€), deri në fund të ditës duhet të depozitohen në llogari përkatëse të autorizuar. Shuma prej 1,059€ që i përket të hyrave nga shëndetësia ishte deponuar me datën 23/01/2017, ndërsa të hyrat ishin grumbullim i parave në QKMF që nga muaji qershor 2016 deri në muajin janar 2017. Deponim ishte bërë me vonës prej 10 ditë deri në shtatë muaj. Gjithashtu të hyra të inkuar në para të gatshme në vlerë 1,332€, nga data 12/07/2017 deri 24/07/2017, ishin deponuar në bankë me datë 25/07/2017, pra kishte vonesë prej 2 deri 12 ditë.



**Rreziku** Depozitimi i vonuar i parasë së grumbulluar në arka rritë rrezikun e keqpërdorimit të parasë publike. Kjo shpie të raportimi jo i drejt i periudhës kohore të grumbullimit të të hyrave përkatëse, dhe përveç kësaj, një praktikë e tillë nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

**Rekomandimi 15** Kryetari duhet të sigurojë se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

### 3.11 Të arkëtueshmet

Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave në PFV është 1,752,000€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë në vlerë 890,000€, taksa në firmë 618,000€, si dhe të arkëtueshmet nga shfrytëzimi i pronës komunale 244,000€. Në përgjithësi vlera e të arkëtueshmeve ka shënuar një rënie simbolike vetëm për 1% në krahasim me vitin e kaluar.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.12 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve nga 3,000€ sa ishin në fund të vitit 2016 janë rritur në 7,000€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Komuna përballet edhe me detyrime kontingente ku në PFV janë prezantuar në vlerë prej 248,000€.

#### Çështja 16 - Vonesa në pagesën e faturave

**E gjetura** Gjatë analizimit të raportit të obligimeve të prezantuar në PFV kemi vërejtur se 17 fatura në vlerë 5,132€ kanë kaluar afatin prej 30 ditësh për pagesë. Këto obligime të papaguara ngarkojnë drejtpërsëdrejti buxhetin e vitit 2018, siç është rasti i ekzekutimit të pagesave direkte nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësore.

**Rreziku** Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota mund të dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat në pagesa.

**Rekomandimi 16** Kryetari duhet të përcaktojë të gjitha masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 ka rezultuar në 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, vetëm një rekomandim është zbatuar, dy ishin në proces dhe 12 nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 janë bartur edhe 19 rekomandime, dy të zbatuara, katër në proces dhe 13 të pa zbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

### Çështja 17 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

**E gjetura** Komuna, ka hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i tyre monitorohet formalisht. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim pritet të identifikohen dhe adresohen.

Si pasojë dobësitë e prezantuara në raportet e viteve paraprake ende janë evidente si: mos realizim i kënaqshëm i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, mos regjistrim të plotë të pasurisë, dhe jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ për koordinimin e realizimit të inkasimit të të hyrave.

**Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontroleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

**Rekomandimi 17** Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

---

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Sipas standardeve të auditimit të Qeverisjes së mirë, parimet themelore në këtë fushë janë: llogaridhënia, efektiviteti i kontrolleve, menaxhimi i rreziqeve, pavarësia e auditimit të brendshëm, koordinimi i ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe zhvillimi i qeverisjes së mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në qeverisjen lidhur me aktivitetet operationale dhe financiare në komunë, ende mbetin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Përgjigjet efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, zhvillimi mbi proceset e menaxhimit të rrezikut, menaxhimi i projekteve kapitale dhe pasurisë komunale, si dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë disa nga fushat të cilat komuna duhet dhënë prioritet sa i përket një qeverisjeje më efektive.

Komuna kishte hartuar: Planin Zhvillimor Komunal 2013-2023 dhe Planin operativ të veprimit emergjent dhe civil për komunën e Dragashit, mirëpo mungonte Strategjia kundër korrupsionit, Planet urbanistike hapësinor dhe rregullative, si dhe lista e rreziqeve me të cilat mund të ballafaqohet.

Për shumicën e aktiviteteve komunale ka një komunikim dhe raportim të mirë mes bartësve të njësive dhe kryetarit, të përcjella me procesverbale, por mungon monitorimi strategjik, si dhe nuk ka një raportim formal dhe sistematik (monitorim) që i ndërlidh objektivat e komunës me rezultatet.

---

## 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me një (1) anëtare, Drejtorin e NjAB-së. Përveç Planit strategjik, kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës sipas të cilit ka planifikuar katër auditime të cilat ishin realizuar në tërësi. Auditimet kanë mbuluar fushën e prokurimit, të hyrat, shpenzimet komunale sipas linjave buxhetore si dhe menaxhimin e pasurisë.

Marrë parasysh buxhetin e komunës, sipas kërkesave UA. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e NjAB-së, përbërja e kapaciteteve të kësaj njësie me vetëm një auditor, nuk është e mjaftueshme.

---

### Çështja 18 - Mangësi në funksionimin e NjAB

Në katër raportet e përfunduara NjAB kishte dhënë 28 rekomandime se si menaxhmenti të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm, nga të cilat 13 ishin të proces të zbatimit, ndërsa 15 kanë mbetur të pazbatuara. Po ashtu zbatimi i rekomandimeve të dhëna edhe për vitin 2016 nuk ishte në nivelin e duhur. Nga 30 rekomandime, vetëm gjashtë janë zbatuar, 11 ishin në proces të zbatimit, ndërsa 13 kanë mbetur të pazbatuara.

Komuna nuk kishte arritur ende edhe gjate kësaj periudhe të themelojë Komitetin e Auditimit (KA) i cili do ndihmonte dhe përmirësonte funksionimin e këtij sistemi.

#### **Rreziku**

Dështimi për të adresuar rekomandimet e auditimit rrisin rrezikun që dobësitë e identifikuar nga auditimi të mbesin të pazbatuara dhe potencialisht mund të rezultojnë humbje financiare për komunën dhe vlerë të dobët për para. Në mungesë të kontributit të KA-së zvogëlohet efikasiteti i sistemit të Auditimit të brendshëm si tërësi.

**Rekomandimi 18** Kryetari duhet të sigurojë se do të plotësohet me personel të mjaftueshëm NjAB, si dhe të rishikojë arsyet për veprimet e limituara të ndërmarra në lidhje me rekomandimet. Gjithashtu duhet të ndermirren veprime shtesë për funksionalizimin e KA-të në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.

---

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë kërkesat për vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

---

### Çështja 19 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

**E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo efektiv financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara sidomos mbi monitorimin e strategjisë. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Si të tilla aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes, kërkojnë përmirësim. Ne kemi identifikuar se kontrollet mbi të hyrat nga pronat publike akoma nuk janë mjaft efektive, dhe ka mangësi në kontrolle në disa fusha të shpenzimeve.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Gjithashtu komuna nuk kishte hartuar planet rregullative hapësinore.

**Rreziku** Mos azhurnimi i raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo gjithashtu, mund të ndikoj që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm, mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta.

**Rekomandimi 19** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.



158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për kualifikimin e opinionit të auditimit dhe paragrafin e theksimit të çështjes. Veprimi duhet ndërmarrë për të adresuar dobësitë e rëndësishme në një mënyrë sistematike dhe pragmatike për të zbutur dobësitë e shpalosura në paragrafin e bazës për opinion të kualifikuar, si dhe duhet të marrë masat e duhura për të siguruar pajtueshmëri rregullative të plotë të procesit të përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare (PVF). Deklarata e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës të menaxhmentit i ndërmarrë në përmbajtjen dhe saktësinë e PVF.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë që është zbatuar plani i miratuar i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Komuna ka përgatitur një plan veprimi, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte shumë i ulët.	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar kërkesa për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive dhe sistematike.		Komuna ka plotësuar dhe dërguar pyetësorin e vetëvlerësimit, mirëpo edhe më tutje nuk ishte bërë adresimi i disa fushave me dobësi.	

2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe raportimit të drejtorive komunale për të siguruar angazhime të përmirësuar për të arritur objektivat e veçanta gjatë një viti.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Menaxhimi i Riskut	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procedurat dhe sistemet e menaxhimit të riskut janë krijuar dhe janë funksionale. Për më tepër, përgjegjësia për menaxhimin e riskut është deleguar direkt në një drejtori përkatëse që të sigurojë raportimin mujor mbi zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe të siguroj se risqet janë duke u menaxhuar.			Nuk janë marrë masa.
2.5.3 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2017.			Nuk janë marrë masa.
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komiteti i Auditimit është funksional dhe kryen detyrat e veta siç kërkohet me ligj. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standard të lartë të monitorimit të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, në procesin e raportimit financiar dhe mbikëqyrjen e punës së departamentit të auditimit të brendshëm. Për më tepër, Kryetari duhet të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i AB duhet të drejtohet në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në risk. Gjithashtu, në mënyrë që përfitimet të jenë të dukshme, kryetari duhet të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të AB brenda Komunës.			Nuk janë marrë masa.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të identifikoj shkaqet rrënjësore të mangësive dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar se kërkesat e ligjit të prokurimit janë zbatuar plotësisht.		Disponueshmëria e mjeteve në projektet e testuara ka qenë e mjaftueshme, mirëpo nuk janë përmirësuar planet për menaxhimin e kontratave.	
3.5.1 Shpenzimet tjera	Kryetari duhet të siguroj që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat që ato të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatëse.	Po		
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që dosjet të jenë të kompletuara dhe organizuara mirë dhe të marrë masa në lidhje me nënshkrimin e listës së pagave.		Në dosjet e administratës ka një përmirësim të theksuar, ndërsa në dosjet e drejtorisë së arsimit dhe QKMF ende nuk janë të kompletuar dosjet.	

3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Ne rekomandojmë Kryetarin të ndërmarrë këta hapa: Të ndërmarr hapa për të përmirësuar sistemin e faturimit, arkëtimit, dhe kontabilitetit në mënyrë që të sigurojë kontrolle efikase dhe efektive në faturim, arketim dhe në të hyra. Përmirësimi i procedurave lidhur me sisteme të tilla do të mundësonte menaxhmentin të monitoroj dhe të menaxhoj rreziqet e mëdha, dhe të siguroj që vendimet lidhur me buxhetimin, planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave të bëhen në mënyrë të duhur. Të sigurohet që anketimet dhe kushtëzimi i provizionimit të shërbimeve të bëhet siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2011 dhe Nr. 07/2011. Të siguroj që të gjitha shërbimet e qirave janë ofruar në pajtueshmëri me kontratat dhe faturat.			Nuk janë marrë masa.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të ndërmerr masa dhe të fillohet menjëherë me regjistrimet e pasurive, për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi.			Nuk janë marrë masa.
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komuna mban informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me pasuritë jo-kapitale dhe të siguroj se pasuritë janë zhvlerësuar në bazë të rregullores në fuqi.			Nuk janë marrë masa.
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive kapitale jo-financiare është kryer në pajtim me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare të Organizatave Buxhetore dhe të siguroj se inventarizimi bëhet në baza vjetore.			Nuk janë marrë masa.

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që vlesërimi pasurive kapitale jo-financiare është kryer në pajtim me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare të Organizatave Buxhetore dhe për të siguruar se vlesërimi bëhet në baza vjetore.			Nuk janë marrë masa.
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se Komuna është duke bërë përpjekje maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë në ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në Komunë. Të dhënat e marra duhet të prezentohen si duhet në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika më e mirë do të kërkojë një barazim vjetor të të dhënave në mes të palëve të treta dhe Komunës për investime në Komunën për vitin përkatës.	Po		
3.7.2 Trajtimi i parasë së gatshme	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.			Nuk janë marrë masa.
3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa dhe të hartoj një plan të detajuar lidhur me arkëtimin e borxheve të vjetra.			Nuk janë marrë masa.

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3. Pasqyrat financiare	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes dhe të vendos procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 e adreson shpalosjen e saktë të pasurive komunale.			Nuk janë marrë masa.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse plani i veprimit nuk është kryer me kohë dhe pse rekomandimet e auditimit nuk po zbatohen, dhe të inicoj masa përgjegjësie ndaj të gjithë personave të ngarkuar me këto aktivitete. Pas finalizimit të këtij raporti, Kryetari duhet të përgatit Planin e veprimit me afate dhe aktivitete të qarta dhe të përcaktoj personat përgjegjës për zbatimin në tërësi të këtij plani, duke zbatuar një proces rigoroz të llogaridhënies ndaj stafit përgjegjës. Më tej, për qëllime transparence dhe ngritjes së llogaridhënies, raporti i auditimit duhet të diskutohet në Kuvendin Komunal.		Komuna ka përgatitur një plan veprimi, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte shumë i ulët.	
2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se do të hartohet lista e rreziqeve. Monitorimi i strategjisë duhet të bëhet në baza të vazhdueshme për t'u siguruar se objektivat strategjike janë duke u arritur. Njësia e auditimit të brendshëm duhet të bëjë një rishikim të cilësisë për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese, para se e njëjta t'i dorëzohet Ministrisë së Financave.		Nuk është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Njësia e auditimit të brendshëm ka bërë një rishikim të cilësisë për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese, para se e njëjta t'i dorëzohet Ministrisë së Financave.	
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të hartoj planin e veprimit për monitorimin sistematik të arritjes së objektivave strategjike, duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.			Nuk janë marrë masa.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme për këtë. Po ashtu, të merr masa që raportimet nga ana e ZKF-së të bëhen sipas kërkesave ligjore për progresin fizik të investimeve kapitale.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar. Po ashtu, në pajtim me udhëzimin administrativ nr.11/2010, pa vonesë ta themeloj dhe funksionalizoj komitetin e auditimit.			Nuk janë marrë masa.
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të siguroj që dështimet në procesin e prokurimit dhe problemet e ngritura nga qytetarët, do të shqyrtohen dhe të zgjidhen para se realizimi i projekteve të filloj me punët ekzekutive në terren.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme. Gjithashtu, veprime shtesë duhet të ndërmerren për të siguruar se zbritjet për 10,000€ aplikohen në pajtim me nenin 9 të Ligjit mbi tatimin në pronë.			Nuk janë marrë masa.




3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj organizimin e ankandeve publike në rastet e dhënies me qira të pronave komunale, në mënyrë që të ketë një proces të hapur dhe transparent, si dhe të ushtroj monitorim të vazhdueshëm tek shfrytëzimi i hapësirave publike në mënyrë që pronat komunale të mos shfrytëzohen pa u kryer paraprakisht obligimet sipas rregulloreve.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet dhe shërbimet komunale	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se për secilën kontratë caktohen menaxherët e projekteve dhe të njëjtit përgatitin planet specifike për menaxhimin e kontratave, të ushtrojnë mbikëqyrjen e duhur në realizimin dhe progresin e kontratave dhe të përgatitin raportet e duhura mbi përmbushjen e tyre me kohë.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Për t'iu shmangur kostove shtesë të projekteve dhe cilësisë së dobët, Kryetari i Komunës duhet të siguroj që para fillimit të aktiviteteve të prokurimit për realizimin e projekteve investive, të jetë kryer hartimi i projekteve ekzekutive sipas kërkesave ligjore.			Nuk janë marrë masa.
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëj regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit, të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.			Nuk janë marrë masa.

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj që zyrtari i pasurive, për shkak të mos funksionimit të E-pasurisë, do të zhvilloj një program të përshtatshëm dhe të regjistroj të gjitha pasuritë me vlera nën 1,000€, si dhe të bëj të gjitha hyrje/ daljet kontabël për të konfirmuar të gjitha ndërrimet gjatë vitit dhe gjendjen përfundimtare në fund të vitit.			Nuk janë marrë masa.
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet që të inicoj pa vonesë hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të shqyrtoj ngritjen e një grupi pune të veçantë për shqyrtimin e realizimit të inkasimit të borxheve. Të bëj një analizë të detajuar në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit në pagesën e borxheve, si dhe të shfrytëzoj të gjitha mjetet në dispozicion, duke mos përjashtuar as masat administrative dhe veprimet ligjore.			Nuk janë marrë masa.

## Shtojca III: Letër konfirmimi

REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragash  
N. Br. 400/03-13342  
18.6 20 18  
Dragash - Dragash



Kuvendi Komunal Dragash

**LETËR E KONFIRMIMIT**

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Dragashit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

  
Z. Shaban Shabani  
Kryetar i Komunës,  
Data: 18.Qershor.2018, Dragash,

